

NDOTJA E AJRIT DHE SHËNDETI NË EVROPËN JUGLINDORE




Ndotja e ajrit vazhdon të jetë një shqetësim kryesor shëndetësor në Evropën Juglindore, ku vendet përjetojnë ekspozime ndaj grimcave PM_{2.5} shumë herë mbi vlerën udhëzuese vjetore të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) prej 5 µg/m³.

Ekspozimi ndaj Ndotjes së Ajrit


Ndotja e ajrit është një përzierje komplekse e grimcave dhe gazrave, burimet dhe përbërja e të cilave ndryshojnë në kohë dhe hapësirë.

- Deri në **71%** e popullsisë në këtë rajon jeton në zona që nuk plotësojnë vlerën kufitare aktuale të cilësisë së ajrit të BE-së (vlerën mesatare vjetore prej 25 µg/m³). Megjithatë, të gjitha vendet në rajon përmbushin objektivin e përkohshëm më pak të rreptë të OBSH-së (35 µg/m³) për grimcat PM_{2.5}.
- Ekspozimet **mesatare vjetore më të larta** të grimcave PM_{2.5} në vitin 2019 janë vërejtur për **Maqedoninë e Veriut** (30.3 µg/m³), ndërkohë që **Rumania** kishte **ekspozimin** më të ulët (15.7 µg/m³).
- **Lajm i Mirë:** Ekspozimet mesatare vjetore të grimcave PM_{2.5} janë **ulur** për çdo vend në rajon gjatë dekadës së fundit, me rënien më të madhe në **Serbi**, ku nivelet e grimcave PM_{2.5} në vitin 2019 ishin 19.1% më të ulëta krahasuar me vitin 2010.


Vendet në Evropën Juglindore me ekspozimet më të larta të grimcave PM_{2.5}, Ndotja e Ajrit nga amvisërit dhe Ekspozimi ndaj Ozonit në vitin 2019.



Ekspozimet mesatare vjetore të ponderuara sipas popullsisë ndaj grimcave PM_{2.5} (µg/m³)



Përqindja e popullsisë që mbështetet në lëndë djegëse të ngurta për gatim



Ekspozimi mesatar sezonal 8-orësh i ozonit i ponderuar sipas popullsisë (µg/m³)

Si ka ndryshuar ekspozimi ndaj ndotësve midis 2010 dhe 2019?



Grimcat PM_{2.5} (të paraqitura si përqendrim mesatar vjetor i ponderuar sipas popullsisë)

- **Më e ulët** në vitin 2019 (19.1 µg/m³) se në vitin 2010 (25.5 µg/m³)
- **Më e lartë** se mesatarja EU-28 (11.4 µg/m³)



Ndotja e Ajrit Shtëpiak (% e popullsisë që mbështetet në lëndë djegëse të ngurta për gatim)

- **Më e ulët** në vitin 2019 (23.0%) se në vitin 2010 (27.7%)



Ozoni (i paraqitur si përqendrim mesatar sezonal i ponderuar sipas popullsisë)

- **Më e ulët** në vitin 2019 (82.0 µg/m³) se në vitin 2010 (87.9 µg/m³)
- **Më e ulët** se mesatarja EU-28 (83.5 µg/m³)


STATE OF
GLOBAL AIR

Ndikimet e cilësisë së ajrit në shëndet

Ekspozimet afatgjata ndaj ndotjes së ajrit kontribuojnë në rritjen e rrezikut të sëmundjeve dhe vdekjeve nga sëmundjet kronike jo ngjitëse, të tilla si sëmundjet ishemike të zemrës, kanceri i mushkërive, sëmundjet pulmonare obstruktive kronike (SPOK), goditja në tru dhe diabeti i tipit 2, si dhe infeksionet e rrugëve të poshtme të frymëmarrjes (p.sh., pneumonia) veçanërisht te fëmijët e moshës nën pesë vjeç. Ekspozimi ndaj grimcave PM_{2.5} gjithashtu i vë nënë në rrezik për të lindur fëmijë të parakohshëm dhe më të vegjël se normalja dhe këto foshnje janë më të ndjeshme ndaj vdekjes nga një sërë sëmundjesh ose konsiderohen të jenë në rrezik të shtuar për sëmundje të mëvonëshme në jetë. Ekzistojnë gjithashtu prova të reja mbi rolin e ndotjes së ajrit në ç'rregullimet kognitive duke përfshirë demencën. **MË SHUMË.**

- Ndotja e ajrit renditet ndër 10 faktorët kryesorë të rrezikut për shëndetin e keq në çdo vend të Evropës Juglindore.
- **11.8%** e totalit të **vdekjeve** në Evropën Juglindore (56,300 vdekje) janë të lidhura me ndotjen e ajrit në vitin 2019. Grimcat PM_{2.5} në ajrin e jashtëm përbënin më së **shumti** (46,600 vdekje ose 9.7% të vdekjeve totale) të ë lidhura me ndotjen e ajrit.
- **Rumania** kishte **numrin** më të lartë të vdekjeve që i atribuohen ndotjes së ajrit (17,100) në rajon ndërsa **Mali i Zi** kishte **më të ulët** (700).
- Normat e vdekjeve të lidhura me grimcat PM_{2.5}- tejkalojnë shkallën globale prej 53.5 vdekje/100,000 popullsi në tetë nga nëntë vende - Sllovenia është përjashtimi i vetëm.
- Mesatarisht, gati **23% e të gjitha vdekjeve të lidhura me SPOK** i atribuohen ndotjes së ajrit. Ndikimet më të mëdha u panë në Bosnje dhe Hercegovinë (30%), Maqedoninë e Veriut dhe në Malin e Zi (secila 26%), ndërsa ngarkesa më e ulët u vlerësua për Rumaninë (14%).

Përqindja e vdekjeve totale duke përfshirë ato të lidhura me ndotësit individualë (Ozoni, grimcat PM_{2.5} dhe ndotja e ajrit nga amvisërit) në Evropën Juglindore në vitin 2019.



Si Ndikon Ndotja e Ajrit tek të Rinjtë dhe të Moshuarit?

- Në të gjithë Evropën Juglindore, numri më i madh i vdekjeve ndodh tek njerëzit e grup moshave 70 e sipër.
- Ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit përbën **7.7% të vdekjeve foshnjore**, ku shumica e vdekjeve janë të lidhura me grimcat PM_{2.5} të ambientit.
- Përqindja **më e madhe e vdekjeve foshnjore** që lidhen me ndotjen e ajrit në vitin 2019 ishte **më e madhe** në Bosnje dhe Hercegovinë (11%) dhe në Maqedoninë e Veriut (10%).

Përqindja e Vdekjeve (sipas Shkakut) të Lidhura me Ndotjen e Ajrit në 2019



22.7%

e vdekjeve nga SPOK



18.7%

e vdekjeve nga diabeti



14.8%

e vdekjeve nga sëmundjet ishemike të zemrës




17.0%

e vdekjeve nga kanceri i mushkërive



15.8%

e vdekjeve nga goditjet në tru-insultet



13.5%

e vdekjeve nga infeksionet e rrugëve të poshtme të frymëmarrjes



7.7%

e vdekjeve neonatale


STATE OF
GLOBAL AIR

Burimet Kryesore të grimcave PM_{2.5} në Evropën Juglindore

Grimcat PM_{2.5} gjenerohen si nga burime natyrore dhe antropogjene (ose të krijuara nga njeriu). Burimet e zakonshme natyrore përfshijnë pluhurin e fryrë nga era, spërkatjen nga deti dhe zjarret e egra, ndërsa burimet antropogjene përfshijnë djegien e lëndëve fosile dhe biokarburanteve, proceset industriale, bujqësinë dhe menaxhimin e mbetjeve. Për të identifikuar veprimet prioritare dhe zgjidhjet më ekonomike, është thelbësore të kuptohen burimet kryesore, veçanërisht burimet antropogjene, të ndotjes së ajrit.

- Kontribues të rëndësishëm të karburantit për grimcat PM_{2.5} ekspozimet në rajon përfshijnë **qymyrin, karburantet e lëngshme dhe gazin natyral dhe biokarburantet e ngurta**.
- Si burime individuale, **burimet** nga shtëpitë kontribuan më shumë (20%) për grimcat PM_{2.5} vdekjet e atribuara në vitin 2019, e ndjekur nga **prodhimi i energjisë** (18%), **pluhuri i fryrë nga era** (13%), **bujqësia** (13%) dhe **transporti** (7%).

Përqindja e grimcave PM_{2.5} nga Pesë Burimet Kryesore në Nëntë Vende të Evropës Juglindore në vitin 2019



Burimi i të dhënave: McDuffie E, Martin R, Yin H, Brauer M. 2021. Barra globale e sëmundjeve nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit (GBD MAPS): A Qasja globale. Raporti Kërkimor 210. Boston, MA: Instituti i Efekteve Shëndetësore.

PËR MË SHUMË INFORMACIONE:

Për më shumë informacione mbi ndotjen e ajrit dhe shëndetin në Evropën Juglindore, lexoni [raportin](#) e plotë

Eksploroni dëshmitë e disponueshme mbi ndotjen e ajrit dhe shëndetin në Evropën Juglindore [këtu](#)

Për të eksploruar dhe shkarkuar të dhënat, ju lutemi vizitoni www.stateofglobalair.org.



Për më shumë detaje, ju lutemi vizitoni

www.stateofglobalair.org

Na kontaktoni

SEE@healtheffects.org



IHME



Faqja e internetit e Raportit Global të Cilësisë së Ajrit është një bashkëpunim midis Institutit të Efekteve Shëndetësore dhe Institutit për Metrikat dhe Vlerësimin e Shëndetit, me kontributin e ekspertëve nga Universiteti i Kolumbisë Britanike

STATE OF
GLOBAL AIR